



INSTITUTI I TESTIMIT TË MATERIALEVE

**“NDËRTIMI I RRUGËS SË FSHATIT ISMAJLE DHE
ÇEKËVE, FSHATI GËRBLLESH”, BASHKIA TIRANË**

RAPORT GJEOLIGO-INXHINIERIK

**MBI KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE PËR “NDËRTIMIN E RRUGËS SË
FSHATIT ISMAJLE DHE ÇEKËVE, FSHATI GËRBLLESH”, BASHKIA TIRANË**

POROSITËSI: “HE & SK11” Sh.p.k

Tiranë, Mars 2024

Përmbajtja

1 - HYRJE	4
1.1 - Objektivi i Punimeve	4
1.2 - Morfologjia.....	4
2- NDËRTIMI GJEOLIGO – STRUKTUROR I ZONËS.....	5
2.1- Stratigrafia	5
3 - TEKTONIKA	8
4 - KUSHTET HIDROGJEOLIGJIKE.....	8
5- PROCES GJEODINAMIKE (Gjeo hazardet).....	8
1-Rrëshqitjet e dheut.....	9
2- Konsolidimi depozitimeve të dherave	9
3-Erozioni -.....	9
4-Tjetërsimi është fizik dhe kimik	9
5-Termetet (risku sizmik) dhe neotektonika	10
6-Tërmetet kryesore.....	10
6 - PUNIMET FUSHORE	11
6.1- Qëllimi i Punimeve Fushore	11
6.2- Inspektimi i Punimeve në Terren	11
6.3- Planifikimi i thellësisë së investigimit në terren.....	11
6.4- Marrja e Kampioneve	11
6.5- Matja e Nivelit të Ujit Nëntokësor	11
7- ANALIZAT LABORATORIKE	11
7.1-Qëllimi i provave.....	11
7.2-Testimet Standarte	12
7.3-Testimet e Dherave.....	12
7.4 -Testimet në Shkëmbinj	12
8- REZULTATET E STUDIMIT NE TERREN	12
9- KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE.....	13
9.1- Kushtet gjeologjike të trasesë së rrugës në gërmime.....	18
9.2 - Kushtet gjeologjike të zonave ku traseja e rrugës është në mbushje.....	19

9.3 - Gërmimet e Skarpatave dhe masat Inxhinerike për stabilizimin e tyre	19
9.4 -Thellësia e gërmimit dhe këndet e pjerrësisë së gërmimeve në dhera.....	20
9.5- Mbrojtja dhe trajtimi i skarpatave	21
9.6 - Skarpata në shkëmbinj terigjen (mollaset)	22
10- RAPORTI MBI MATERIALET E NDËRTIMIT	23
11-KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	24
12 - REKOMANDIME	25

1 - HYRJE

Ky studim i referohet termave të referencës *“Ndërtimin e rrugës së fshatit Ismajle dhe Çekëve, fshati Gërbllesh”, Bashkia Tiranë.*

Kërkohet studim gjeologjik për trasenë e rrugës së fshatit Ismajle dhe Çekëve, fshati Gërbllesh”, Bashkia Tiranë.

Zona e projektit shtrihet në një terren kodrinor, në zonën qendrore të Shqipërisë. Zona e projektit administrohet nga Bashkia Tiranë.

1.1 - Objektivi i Punimeve

Raporti shqyrton çështjet të cilat janë të mbështetura me punimet gjeologjike sipas programit të miratuar nga porositësi dhe të zbatuar nga grupi i punës.

1. Janë rishikuar të gjitha punimet e mëparshme gjeologjike të kryera nga autorë të tjerë vendas të cilat janë kryer për qëllime të tjera por kanë vlera njohëse.

2. Janë studiuar punimet gjeologjike të vjetra që janë kryer për zonën e rajonit Hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të zonës.

3. Janë kryer punime të ndryshme sipas programit të hartuar, por të kombinuar dhe me punimet ekzistuese të cilat janë shumë të rëndësishme për të kuptuar fenomenet gjeologjike që kanë ndodhur në zhvillimin e historikut gjeologjik të kësaj zone.

4. Në këtë studim me vëmendje u trajtuan zonat dhe shpatet e luginës të ndërtuara nga shkëmbinj të ndërtim të karakterit terigjen, pranisë së mbulesave deluviale, sidomos mbi këto depozitime, tjetërsimit të shkëmbit në shpatin ku ëshë traseja e rrugës, rënies së shtresave në raport me luginën, etj.

Për formacionet shkëmbore ranorët shtresë trashë, vëmendja u përqendrua në gjendjen e shkëmbit në masiv, çarshmërisë thyerjeve tektonike, zonave me copëtim e thërmim të shkëmbit, prekjes së tyre nga dukurit karstike, pranisë së ujrave nëntokesore e sipërfaqësore, që mund të ndikojnë në dobësimin e vetive fiziko - mekanike të tyre, etj.

Raporti studimor shoqërohet me hartën gjeologjike dhe topografike në shkallë 1:25000, prerje gjeologo - litologjike trrasese se rrugës të variantit të paraqitura nga projekti.

Për realizimin e këtij studimi janë kryer punimet e mëposhtme:

a) Janë interpretuar shtresat terrigjene me thellësi 3,5m dhe deri 3,0m.

b) Eshtë kryer një investigim i detajuar gjeologo inxhinierik në shkallë 1:25000

c) U krye interpretimi i të dhënave in-situ me CPT, hartimi i raportit përfundimtar.

Studimi është kryer konform standarteve bashkohore (eurokodi – 7).

-ISO – 22475-1- Geotechnical investigation and testing.

-EN 1997 – 1 - Geotechnical designe.

-EN 1997 – 7 - Geotechnical testing (Ground investigation and testing).

1.2 - Morfologjia

Sipas ndarjes gjeografike të Shqipërisë zona në studim, rruga e fshatit Ceke, Njësia Administrative Ndroq gjeografikisht shtrihet në krahinën kodrinore në pjesën veri - lindore të saj. Ajo kalon nëpër shpatin e kodrës, në krahun e djathtë të luginës së lumit Erzen, dhe lidhet me rrugën nacionale Tiranë - Ndroq. Brenda kësaj hapësire traseja ndërpret një sërë shkëmbinjësh, të cilët kushtëzojnë formën e luginave dhe shpateve të kodrave dhe gjeomorfologjinë e zonës. Pra rruga është me vendvendosje të trasesë në segmente të shpateve të kodrave, ku ndërtimi gjeologjik, morfologjik e problemet gjeologo - inxhinierike, kushtëzojnë zgjidhjen e projektit.

2- NDËRTIMI GJEOLIGO – STRUKTUROR I ZONËS

2.1- Stratigrafia

Tortoniani (N_1^3t)

Këto depozitime kanë përhapje të gjerë si në sipërfaqe dhe thellësi. Ato hapen në të dy krahët e antiklinalit të Kavajës dhe në gjithë monoklinalin e Prezës. Njëkohësisht këto depozime janë takuar edhe në thellësi nga shumë puse të shpuar në strukturat neogjenike të Ultësirës.

Depozitimet e Tortonianit si në sipërfaqe dhe në thellësi përfaqësohen nga dy litofacie; Litofacia ranoro – argjilore, e cila ka përhapje në pjesën periferike të Ultësirës Adriatike dhe të zonës së Adriatikut Jugor, sidomos mbi orogjen e pranë tij, si dhe litofacia argjilo-ranore që takohet në pjesën perëndimore të Ultësirës Adriatike dhe gjithë qëndrën e basenit. Litofacia ranoro - argjilore karakterizohet nga ranore e argjila të ndërthurur dhe me gëlqerorë lithotamnike.

Ranorët paraqiten me ngjyrë gri të çelur deri të zverdhur, ndërsa në thyerje të fresket kanë ngjyrë bezhë të errët. Janë kompakte, kokërmëdhenj, deri kokërrmesëm. Trashësitë e shtresave luhaten nga 0.5-1.5m. deri 5-6m.

Argjilat paraqiten me ngjyrë gri në të kaltërt me ndërtim guackor dhe me trashësi 2-3m deri 15-20m. Shpesh brenda tyre takohen horizonte të ndjekshëm me makrofaune 1-2m të trashë si dhe shumëngjyresha. Në disa rajone tek horizontet e makrofaunës dallohen kristale të vegjël gipsi.

Gëlqerorët lithotamnike paraqiten në trajtën e shtresave me përhapje jo shumë të madhe dhe me trashësi 2-3m deri 7-8m, ndonjëhere përmbajnë shumë lithotamnë dhe makrofaune të llojeve të ndryshme. Këto të fundit takohen në pjesën e sipërme të tyre, kur litologjikisht kalojnë në argjila alevrolitore.

Kjo litofacie karakterizohet nga depozitime të një ambienti të cekët, kryesisht shelfore ndërsa litofacia tjetër argjilo-ranore për një ambient të thellë. Karakteristikë e litofacies së dytë është se trupat ranore janë të tipit linzor, me përhapje të kufizuar dhe të formave gjenetike më tepër kanalore.

Në pjesën verilindore të Ultësirës Adriatike depozitimet e Tortonianit vendosen suksesivisht mbi ato të Serravalianit.

Messiniani (N_1^3m)

Në Ultësirën Adriatike depozitimet e Messinianit ekspozohen në sipërfaqe në një varg strukturash të ndryshme. Ato hapen në veri, duke ndërtuar krahun perëndimor të ngritjes së Golem-Kavajës e akoma më në veri vazhdojnë deri në Kepin e Rodonit. Ndërsa në thellësi këto depozitime janë takuar pothuajse në të gjithë pusët e shpuar për zbulimin e vendburimeve të naftës e gazit në Ultësirë dhe në det kohët e fundit.

Nga ana litologjike ekzistojnë dy litofacie, duke pasqyruar pak a shumë të njëjtën histori zhvillimi si në Tortonian.

Në rajonet lindore të Ultësirës dhe në përgjithësi në gjithë periferinë e saj sidomos mbi orogjen, takohet litofacia ranoro-argjilore, ndërsa gjithë pjesa tjetër e Ultësirës Adriatike dhe e basenit, përfaqësohet nga facia argjilo-ranore. Në hapsirën, ku gjen përhapje litofacia e dytë, në pjesën e sipërme të saj, takohet dhe litofacia gipsmbajtëse.

Litofacia ranoro-argjilore përfaqësohet nga ndërthurje paketash ranorike me paketa argjila-alevrolitore. Ranorët predominojnë në prerje dhe paraqiten në trajtën e paketave me trashësi 6-7m. deri 15-20. Në përgjithësi janë kokërrndryshëm, më shtresëzim të pjerrët dhe rrallë

herë vërehen dhe zaje të vegjël midis ranorëve. Në rajonet ku prerja dominohet nga ranorët, sidomos gjatë buzës anësore të Ultësirës Adriatike, takohen dru të fosilizuar, mungon facia gipsmbajtëse dhe prerja deri në tavan është krejt ranorike.

Argjilat kanë pamje më tepër alevrolitore dhe paraqiten me ngjyrë gri-hiri. Midis tyre takohen disa horizonte makrofaune të tipit kryesisht ostrea, të ndjekëshme në distanca të mëdha.

Litofacia argjilo-ranore, ndryshe nga ajo ranoro-argjilore, karakterizohet për një ambjent të thellë ku në përgjithësi predominojnë argjilat. Argjilat paraqiten në trajtën e paketave të trasha, dhjetra metroshe të cilat në drejtim të lindjes kalojnë dora-dorës në argjila jo të pastërta deri me alevrolite.

Ranorët paraqiten shtresorë, por me përhapje të kufizuar dhe të tipit linzor të formave gjenetike kryesisht kanalore. Më sipër vihet re se prerja bëhet më ranorike, gjë që lidhet me ciklin regresiv të sedimentimit.

Litofacia gipsmbajtëse kudo përfaqësohet nga argjila e alevrolite të ndërthurura me gipse shtresëtrashë. Midis tyre ndodhen dhe shtresa të rralla ranorësh.

Gipset kanë përhapje në trajtë linzash brenda hapsirës së kësaj litofacie dhe trashësi deri disa metra. Krahas gipseve ndonjëherë ndeshen anhidrite dhe kripra (miniera e Kavajës). Në rajonin e Tragjasit e Dukatit në shtresat e gipseve takohen copa e blloqe të gëlqerorëve të moshave të ndryshme. Kjo litofacie siç u theksua me lart, drejt buzës së Ultësirës kalon në ranorë shtresë trashë deri zhavorre.

Plioceni (N₂)

Depozitimet Pliocenike përhapen gjerësisht në Ultësirën Adriatike, duke zënë sipërfaqe të mëdha të saj.

Nga ana litologjike këto depozitime përfaqësohen nga dy pako me karakteristika të ndryshme litologjike të ndarshme në sipërfaqe dhe thellësi, që vendosen me njëpasnjëshmëri normale dhe shoqërohen me treguesit zonal biostratigrafik të tyre.

Brenda trashësisë së plotë pliocenike, në Ultësirën Adriatike veçohen dukshëm dy formacione litostratigrafike të njojtura me emërtimet formacioni “Helmasi” dhe “Rrogozhina”. Studimet biostratigrafike të kryera kanë saktësuar përkatësinë e këtyre formacioneve respektivisht si të Pliocenit të poshtëm dhe Pliocenit të mesëm.

Plioceni i poshtëm (N¹₂ h)

Depozitimete e formacionit "Helmasi", fillojnë me shfaqjen në prerje të shtresave ranore dhe konglomerateve të pangopur, që përcaktojnë dyshtresën e tij dhe njëkohësisht shënojnë praninë e transgresionit pliocenik. Mbi shtresat ranore dhe konglomeratike prerja vijon me shtresa argjilore dhe paketa argjilo-ranore shtresë hollë e mesëm deri në praninë e argjilave masive.

Ranorët kanë forma shtresore me trashësi nga 4-8 cm deri në 20-30 cm, ngjyrë hiri të verdhë, të shkrifët nga çimentimi i dobët. Ata janë kokërrvegjël dhe mesem, polimineral, të tipit kuarcoro-feldshpatik.

Argjilat predominojnë në prerje, janë gri hiri deri në të kaltertë, të buta deri në kompakte, herë-herë shumë mikore.


Konglomeratet përbëhen nga zaje të përbërjes dhe formave të ndryshme. Takohen zaje të rrumbullakuara e gjysëm të rrumbullakuara me madhësi mesatare 4-10cm. Janë kryesisht zaje kuarcitesh, serpentinite, gabro-dunitesh si dhe gëlqerore e ranore të moshave të vjetra deri në të reja, duke filluar nga ato të Jurasikut

Deopzitimet e kuaternarit.

Sipas mënyrës së formimit këto depozitime do të ndahen në depozitime aluviale; depozitime proluviale dhe depozitime lagunore detare.

- *Depozitimet aluviale* përfaqësohen nga depozitimet e lumenjër të zonës si lumi i Kardhiqit. Këto depozitime ndërthuren me depozitimet liqenore dhe detare, përfaqësohen nga suargjila argjila lymore surëra dhe rëra me rrallë në thellësi mbi 25.00m dhe shtresa zhavoresh. Janë depozitime pak deri mesatarisht të konsoliduara, takohen në zonën fushore dhe kanë trashësi 50-60m

- *Depozitimet proluviale* përfaqësohen nga formimet e disa përrenjër të zonës. Në disa raste këto depozitime ndërthuren me depozitimet aluviale, përbëhen nga suargjila, zhavore, rëra dhe surëra. Janë mesatarisht të konsoliduara dhe takohen në shtratin e përrenjërve. Kanë trashësi 8 - 15 metra. Janë prezente në zonën ku kalon rruga e re në zonat e kodrave.



Harta Gjeologjike e zonës

3 - TEKTONIKA

Shtrihet pranë buzës lindore të Ultësirës, duke filluar nga Kanina-Treblova, e më në veri me mulden e Galushit dhe akoma më në veri me sinklinalin e Tiranës.

Në pjesën verilindore dallohet qartë vendosja transgresive e depozitimeve të Mocenit të sipërm mbi linjat antiklinale të zonës Kruja. Kjo njësi në shumë studime është emërtuar “depresioni Tiranë-Ishëm”.

Buza perëndimore e sinklinalit që kufizohet me tektonikë të re prapahipëse me monoklinalin e Prezë ka kontrast të dukshëm në reliev dhe është më aktive nga pikpamja e gjenërizimit të tërmeteve.

Monoklinali i Prezës ndërtohet nga depozitime të Miocenit të sipërm-Pliocen me rënie nga perëndimi 15-20°. Në drejtim të jugut lidhet me sinklinalin e Pezës i cili mbushet nga depozitimet e Seravalianit, Tortonian-Messinianit e më të reja. Ky monoklinal në skain verior pritët nga tektonika tërthore buzë detit tek Kepi i Rodonit e cila e ka ulur një pjesë të Kalasë së Skënderbeut nën ujrat e Adriatikut. Kjo shpëputje aktive ka qënë edhe shkaku i përqëndrimeve të tërmeteve në këtë sektor. Në jug të sinklinalit të Pezës, vazhdon mulda e Galushit e ndërtuar nga depozitimet e Messinian-Tortonianit.

4 - KUSHTET HIDROGJEOLOGJIKE

Mbështetur në ujëpërshkueshmërinë e formacioneve që ndërtojnë zonën e studimit veçohen komplekset ujëmbajtëse:

- Kompleksi ujëmbajtës mollasik argjilo - alevrolito – ranor
- Kompleksi ujëmbajtës i kuaternarit

Litogjikisht rajoni në studim përbëhet nga:

- a. ***Shkëmbinjtë terrigjen*** që paraqiten depozitimet e mollaseve argjilo-ranor me moshë Tortonian e Mesinian ($N_1^{3t} - N_1^{3m}$).
- b. ***Shkëmbinjtë aluvional, deluvional e proluvional*** që mbivendosen transgresivisht mbi gëlqeror e flish me moshë Quaternare (Q_{4al} , Q_{4dl} e Q_{4prl}).

Kompleksi Ujmbajtes mollasik ($N_1^{3t} - N_1^{3m}$)

Në këtë objekt përfshihen ujrat e depozitimeve terigjene të mollaseve ranoro – argjilor, ku ranorët masiv dhe shtresë trashë krijojnë kushte për depozitim të ujërave dhe lëvizjen e tyre brenda kolektorëve ranor, të kurthëzuar nga shtresat argjilore midis tyre. Këto ranorë furnizohen me uji nga rreshjet atmosferike në zonat e ekspozuara në sipërfaqe, dhe burimet e tyre janë me prurje të vogla 0,1 – 1 l/s.

Komplekset Ujmbajtëse aluvional, deluvional e proluvional të Quaternare (Q_{4al} , Q_{4dl} e Q_{4prl})

Këto depozitime janë të kufizuara në rajon. Megjithatë ato kanë kontributin e tyre në rezervat ujore.

5- PROCES GJEODINAMIKE (Gjeo hazardet)

Ndonjëherë rreziqet nuk janë të dukshme derisa të vihen në dukje. Të gjitha rreziqet gjeologjike (gjeohazards) mund të konsiderohen të fjetura derisa të shkaktohen. Kur ndodh rreziku, atëherë mund të quhet ngjarje, aksident, emergjencë, incident ose fatkeqësi. Studimi dhe monitorimi i rreziqeve gjeologjike na ndihmon të përgatitemi më mirë dhe t'u përgjigjemi këtyre ngjarjeve gjeologjike kur ato ndodhin.

Gjeo-rreziqet mund të jenë tipare të vogla që kanë ndikim vetëm në zonën e tyre lokale, si p.sh. një rrëshqitje e vogël dheu që bllokton pjesërisht një rrugë ose gjurmë, deri te tërmetet e mëdha që prekin qytete të tëra. Ato gjithashtu mund të jenë ngjarje shumë të mëdha që kanë një ndikim të gjerë, si cunami i madh. Proceset gjeodinamike në zonën e studimit lidhen ngushtë me energji e brendshme dhe energjinë e jashtme. Me energjinë e brendshme lidhet tektonika dhe neotektonika ndërsa, me energji e jashtme lidhet tjetërsimi, rrëshqitjet dhe erozioni. Fenomenet më të dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike që vërehen në këtë zonë janë:

- *Rrëshqitjet e dheut*
- *Konsolidimi depozitimeve të dherave*
- *Erozioni*
- *Fenomeni i tjetërsimit të shkëmbinjëve*
- *Tërmetet (risiku sizmik)*

1-Rrëshqitjet e dheut

Rrëshqitje dheu është lëvizja e dheut, shkëmbinjve dhe mbeturinave në një shpat. Rrëshqitjet e dheut shpesh ndodhin si pasojë e fatkeqësive të tjera natyrore, si tërmetet, shpërthimet vullkanike, dhe përmbytjet (rrëshjet). Këto depozitime përbëhen nga shtresa suargjilash dhe argjilash me përbajtje lëndësh organike dhe copa e blloqe nga shkëmbi rrënjësor. Mbulesa deluvialo-eluviale e krijuar nga procesi i tjetërsimit (erozioni) të shkëmbinjëve është vendosur mbi formacionin rrënjësor. Edhe në rastin e gjërmimeve të themeleve, pjerrësia e skarpateve ndikon në qëndrueshmërinë e rrëshqitjen e dherave.

2- Konsolidimi depozitimeve të dherave - është i dukshëm tek formacionet aluvionale dhe deluvionale që përbëhen nga argjilite, alevrolite, rëra dhe zhavore, të cilët janë depozitime të reja, me çimentim të dobët argjilor. Aluvionet nën veprimin e ngjeshjes dhe prezencën e ujërave nëntokësor transformohen në depozitime të teracave lumore. Është e rëndësishme që koha e konsolidimit dhe ndryshimi i volumit (uljet e trashësisë për shkak të ngjeshjes së tyre) duhet të meren parasysh në llogaritjet konstruktive të objekteve.

Shtresat e argjilave konsolidohen nën veprimin e ngarkesave për një kohë relativisht të gjatë, vet ndërtimi strukturor mineralogjik të argjilave që ka në përbërje ujin në tre forma: në hapsirat midis peletave (uji i filtrueshëm), uji tensioaktiv që vesh peletat, dhe uji në përbërjen molekulare të argjilave (metamorfizimi i argjilave nga montmorillonit në kaolinit). Prandaj gjithë ky proces metamorfizues që të arrijë konsolidimin e largimin e ujit kërkon kohën e ngarkesës e vet. Prezenca e lëndës organike gjithashtu e vështirëson dhe zgjat kohën e konsolidimit sepse lënda organike dekompozohet me kalimin e kohës, e gjatë dekompozimit ajo ndryshon volumen e saj dhe sjell ulje të menjëhershme të cilat ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e objekteve të vendosura mbi këto shtresa.

3-Erozioni - është i lidhur me kushtet klimaterike dhe përbërjen litologjike të shkëmbinjëve që ndërtojnë zonën e studimit. Erozioni në zonën e studimit është sipërfaqësor dhe linear.

Erozioni sipërfaqësor - kap sipërfaqe të mëdha të flishit e mollaseve që karakterizohet nga mungesa e bimësisë, nga zona të çveshura dhe intensitet të lartë erozioni. Kjo bën të mundur që të krijohen në këto zona rrjedhje apo rrjedhje-rrëshqitje sidomos në paketat argjilore

4-Tjetërsimi është fizik dhe kimik -Tjetërsimi fizik është shprehur në shkëmbinjtë ranorike, trashësia e tyre arrin deri në 1.0 m. Ndërsa tjetërsimi kimik shprehet me dukurinë e karstit të zhvilluar në gëlqerorët. Karsti është i zhvilluar në formë të ndryshme në struktura të ndryshme.

5-Tërmetet (risku sizmik) dhe neotektonika - rishjet neotektonike shprehen me sizmicitetin e zonës. Sizmiciteti lidhet me vijat sizmogjene me drejtim VP - JL, që i japin zonës së studimit tërmete me intensitet mesatar VI dhe VII ball MKS-64, në bazë të rajonizimit sizmik të Republikës së Shqipërisë.

6-Tërmetet kryesore. Bazuar në sintezën sizmotektonike e gjithë pjesa perëndimore e territorit shqiptar, ku përfshihet dhe rajoni Fier-Vlorë, shtrihet në brezin sizmogjen Adriatiko-Jonik, brez i cili ka aktivitetin më të lartë sizmik në vendin tonë.

Pra, zona burimore sizmike të dalluara në Shqipëri dhe rrethinat e saj janë si më poshtë:

1. Zona Lezhë-Ulqini (LU) me $M_{max} = 7.2$
2. Zona e Ultësirës Peri-Adriatike (PL) me $M_{max} = 7.0$
3. Zona Shkodër-Tropojë (ST) me $M_{max} = 6.5$

Karakteristikat kryesore të Zonave të Burimeve Sizmike (Sh.Alia), E.Sulstarova)

1. Lezha - Ulqini (LU) është një zonë bregdetare e përbërë nga thyerje të pastra me shtytje të shtypjes para Pliocenit ËNË që janë paralele me vijën detare bregdetare Dalmate. Prishjet e shtytjes priten nga shkëputje të rralla të rrëshqitjes me tendencë E-NE. Prishjet e shtytjes para pliocenit janë ende aktive dhe sizmogjene. Prandaj, përgjatë dhe pranë tyre janë regjistruar tërmete të shumta të fuqishme. Ndër to mund të përmenden: 13 janar 1563 Ms = 6.9; 25 korrik 1608 Ms = 7.2; Ap1il 6, 1667 Ms = 7.2; 21 shtator 1780 Ms = 6,6; 1 qershor 1905 Ms = 6,6; 15 prill 1979 Ms = 6.9.

Zgjidhja e mekanizmit fokal të tërmetit April 15, 1979 tregon se kjo zonë thyerje është tani në regjim shtypjeje me një tendencë SW-NE. Pra, tërmetet e ardhshme në zonën Lezhë - Ulqini mund të ndodhin me $M_{max} = 7.2$.

2. Ultësira Peri - Adriatike (PL) është një zonë bregdetare që shtyn thyerjet shtytëse pas Pliocenit, nga veriu deri në N-NË, të cilat priten nga thyerje të rralla të goditjes me tendencë E-NE. Përgjatë zonës së thyerjes të Ultësirës Peri-Adriatike, janë regjistruar tërmete të shumta të forta, si më poshtë: Mars 1273 Ms = 6.6; 17 tetor 1851 Ms = 6.6; 17 dhjetor 1926, Ms = 6,2; September1, 1959 Ms = 6.2; 18 mars 1962 Ms = 6.0.

Studimet mikrotektonike dhe zgjidhjet e mekanizmave fokale të tërmeteve tregojnë se kjo zonë thyerjeje është tashmë në regjim të zhdrejtë të shtypjes. Tërmetet e ardhshme në Ultësirën Peri-Adriatike mund të ndodhin me $M_{max} = 7.0$.

3.Shkodër-Tropojë (ST) është një zonë e brendshme tërthore e përbërë nga thyerje normale me goditje verilindore, kryesisht përgjatë kufirit të zonës ofiolite të Mirditës. Përgjatë tij janë regjistruar këto tërmete: 7 korrik 1855 Ms = 5.5; 27 gusht 1948 Ms =5.5.

Zgjidhjet e përbëra të mekanizmit fokal të tërmeteve të krijuara nga kjo zonë thyerjeje tregojnë regjimin e tensionit që shtrihet N-WN. Duke pasur parasysh se zona Shkodër-Tropojë ka një mjedis të ngjashëm me zonën Elbasan-Dibër-Tetova, tërmetet e ardhshme mund të ndodhin edhe këtu me $M_{max} = 6.5$.

4. Sfondi i Shqipërisë Lindore është një zonë sizmike, që përfshin pjesën e brendshme të Shqipërisë dhe rajonet fqinje që shtrihen në lindje të zonave bregdetare, e cila nuk është marrë në konsideratë për llogaritjen e rrezikut, për shkak të magnitudave të ulëta se Ms 4.5, Madhësia minimale e pranuar për llogaritjen e rrezikut.

6 - PUNIMET FUSHORE

Për përcaktimin e kushteve të detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike të rrugës së re në bashkëpunim me grupin e projektimit është hartuar një program i detajuar që do të respektohet nga “ITM” Sh.p.k.

6.1- Qëllimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kanë për qëllim të përcaktojnë në terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike në zonën ku kalon aksi i rrugës egzistuese. Në fazën e punimeve fushore janë prodhuar hartat gjeologjike të shkallëve të ndryshme. Në këtë fazë do të identifikohen dhe fenomenet negative fiziko-gjeologjike që janë prezente në këtë zonë.

6.2- Inspektimi i Punimeve në Terren

Të gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike, gërmimet e mëdha, për vendet e ndërtimit të tumbinove dhe bokseve, për materialet e ndërtimit, gropat për klasifikimin e dherave të bazamentit të rrugës së re janë kryer nën mbikqyrjen e inxhinierëve të kompanisë “ITM” Sh.p.k dhe në të shumtën e rasteve janë inspektuar nga përfaqësuesi i porositësit. Inxhinieret e kompanisë do të mbajnë të gjitha shënimet fushore të cilat do të krahasohen me të dhënat laboratorike. Mbi bazën e të dhënave të korrektuara, përshkrimi fushor dhe rezultate laboratorike është bërë përpilimi i raportit gjeologjik.

6.3- Planifikimi i thellësisë së investigimit në terren

Para fillimit të punës në terren është bërë studimi i draftit të projektit të detajuar mbi bazën e të cilit janë projektuar punimet fushore.

- a) Për të vlerësuar truallin janë kryer 4 teste CPT me thellësi 3,5m.
- b) U kryen punime gjeoelektrike me profil gjatësor sipas trasesë dhe tërthor saj.
- c) Për të vlerësuar kushtet gjeologjike të boxeve janë kryer investigime me thellësi deri në 5.00m.

6.4- Marrja e Kampioneve

Janë përdorur të dhënat e kampioneve të punimeve të mëparëshme. Janë kryer matje CPT për depozitimet terigjene.

6.5- Matja e Nivelit të Ujit Nëntokësor

Mbasi mbaron shpimi i CPT, përshkrimi i shtresave dhe marrja e kampioneve, gropat lihen të hapura për disa orë për të pritur grumbullimin e ujit dhe për të matur nivelin e tij. Nga punimet fushore nuk janë vërejtur ujra nëntokësor, kjo për faktin se gjithë traseja vendoset në depozitime shkëmbore (ranore, praktikisht pa ujë). Këtu flitet vetëm për ujra sipërfaqësore. Nga gropat merret kompioni për vlerësimin e përbërjes kimike të ujërave nëntokësore (nëse ka).

7- ANALIZAT LABORATORIKE

7.1-Qëllimi i provave

Testimet u kryen për të përcaktuar karakteristikat fiziko-mekanike të llojeve të dherave dhe të shkëmbinjëve, të cilat janë me strukturë të prishur dhe të paprishur. Janë kryer testime me CPT. Përpunimi i të dhënave CPT janë kryer pranë laboratorit “ITM” Sh.p.k, në Tiranë.

Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i tyre janë kryer duke ndjekur kërkesat e konsulentit, si dhe duke ndjekur procedurat në fuqi të Manualit të Cilesisë së laboratorit “ITM” Sh.p.k i

cili është i çertifikuar nga DA. Këto procedura që janë konform ISO 9001 – 2008 dhe EN ISO 17025-2006 garantojnë cilësinë dhe saktësinë, si dhe një raport të plotë e të hollësishëm të provave të kryera. Pajisjet dhe instrumentet matese të laboratorit të vlefshme për këto prova ruhen shumë mirë, në mënyrë që të garantojnë kryerjen e saktë të provës. Çdo pajisje kontrollohet periodikisht sipas procedurës së Manualit të Cilësisë.

7.2-Testimet Standarte

Ne kemi përshkruar më sipër mënyrën e kryerjes së analizave të identifikimit të llojeve të dherave që kanë mbritur në Laborator si dhe standartet e përdorura. Në laboratorin “ITM” provat janë kryer bazuar në standartet BS (British Standard, ASTM, AASHTO, UNI) në çdo çertifikatë të testeve janë të shënuar dhe standartet e përdorura për realizimin e provës. Paisjet që disponon laboratori janë të përshtatshme për të kryer testimet sipas standardeve të mësipërme.

7.3-Testimet e Dherave

Përcaktimi i strukturës së kampionit, ngjyrës dhe fortësisë

Për klasifikimin e kampioneve të testuara është ndjekur një procedurë rigoroze ku çdo kampioni i është vendosur një targë përkatëse sipas të cilës identifikohet plotësisht origjina e kampionit, vendmarrja, thellësia dhe të gjitha hollësitë e tjera të nevojshme. Kampionet e mbërritura në laborator janë ruajtur me kujdesin maksimal, në temperaturë dhe lagështi në mënyrë që të mos kishte ndryshime të karakteristikave të tyre origjinale.

Duke zbatuar kërkesat e kontraktorit dhe konsulentit, në laborator u kryen provat e mëposhtme:

- Përcaktimi i Lagëshirës natyrore, duke ndjekur normativën SSH;CNR;B.U 10014:1998
- Përcaktimi i Kufinjve të plasticitetit, duke ndjekur normativën SSH; CNR; B.U10014:1998
- Përcaktimi i Peshës Specifike duke ndjekur normativën SSH;EN 1097 – 6:2013
- Përcaktimi i Peshës Volumore duke ndjekur normativën BS 1377-2:1990 7
- Përcaktimi i Analizës Granulometrike me sita BS-series, sipas normativës SSH 540 – 6: 1987.

7.4 -Testimet në Shkëmbinj

Në rrugën Senicë, materiali shkëmbor është testuar me metoda që ka në dispozicion laboratori i kompanisë. Në këto shkëmbinj janë kryer provat e mëposhtme:

- Prova e shtypjes njëaksiale për sandstone sipas normativës BS 137 –7:1990 4.
- Prova pikësore (Point load test).
- Prova e proktorit të modifikuar duke ndjekur normativën AASHTO T – 180/C.
- Prova e CBR ne 95% të maksimumit të proktorit duke ndjekur normativën AASHTO T – 193.
- Prova e ekuivalentit të rrës duke ndjekur normativën UNI 8520/15.
- Prova e Los Angeles duke ndjekur normativën UNI 8520/19 e rakorduar me kërkesat e ASTM.

8- REZULTATET E STUDIMIT NE TERREN

Në këtë kapitull do të trajtohet interpretimi i rezultateve të studimit gjeologjik dhe gjeoteknik që është kryer në këtë segment rrugor mbi bazën e punimeve ekzistuese, shpimeve gjeologjike të kryera në rrugën e fshatit Ismajle dhe Çekëve, fshati Gërbllesh”, Bashkia Tiranë. Në studimet ekzistuese janë kryer testime në terren dhe në zyrë të cilat na ndihmojnë për të na dhënë informacion mbi kushtet gjeologo - inxhinierike të kësaj rruge. Janë kryer punime gjeoelektrike, me profila gjatësor sipas aksit të rrugës e tërthor për të përcaktuar

kufirin e gëlqerorëve me flishin. Këto profile janë kryer në segmentet ku përhapen depozitimet terrigjene.

9- KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE

Në bazë të studimit të bërë në sheshin e ndërtimit theksojmë se ka *kushte relativisht të mira Gjeologo-Inxhinierike për ndertime*. Këto depozitime janë terigjene, tipike mollasike me ndryshime litologjike si në thellësi dhe në shtrirje. Për studimin e këtyre depozitimeve u kryen prova CPT. Për vet metodikën e aplikimit të kësaj metode informacioni është dhënë brenda depozitimeve të dherave, pasi në depozitime rrënjësore ajo nuk aplikohet (Goditjejt $N_{spt} > 60$, janë të konsoliduara). Për depozitimet e mëposhtëme të pakos kalimtare që janë argjila kompakte, e mergelore, me ndërshtresa gëlqerori me $N_{spt} > 60$, janë përdorur te dhena te puseve te shpuar ne afersi te objektit tone. Gjithashtu jane kryer punime Gjeofizike te llojit gjeoelektrike, me profila gjatesor sipas aksit te ruges e terthor. Keto profile jane kryer ne segmentet ku perhapen depozitimet terigjene.

Përpunimi i testit të Provës Penetrometrike Dinamike.

Me kërkesë të investitorit u kryen prova me penetrometer dinamik për të karakterizuar nga pikëpamja gjeoteknike truallin. Janë kryer tre prova me Penetrometër Dinamike Pagani TG 30-20 të prodhuar nga Pagani Geotechnical Equipment, Piacenza.

Karakteristika e Paisjes

Penetrometer Dinamik CPT, Tipi Pagani TG 30-20

- Pësia e masës së çekiçit: $M = 30 \text{ kg}$
- Lartësia e lirë që bie: $H = 20 \text{ cm}$
- Diametri Konit: $D = 35.7 \text{ mm}$
- Pësia e konit: $P_p = 12 \text{ kg}$
- Sipërfaqja e bazës konike $A = 10.0 \text{ cm}^2$
- Këndi i hapjes së konit $\alpha = 60^\circ$
- Gjatësia e astës: $L = 100 \text{ cm}$
- Pësia e Astes për metër: $P = 2.4 \text{ Kg}$
- Distanca mes leximeve: $\delta = 10 \text{ cm}$
- zhytja për goditje $e = 10/N(\text{cm})$

Rezistenca dinamike e konit R_{pd} (Formula Olandese)

$$R_{pd} = M^2 H/A e (M+P+P_p) \quad (\text{kg/cm}^2)$$

Shënime të Investigimit:

Përpunimi i të dhënave është i bazuar në korrelacione të njohura empirike duke ofruar një ndërtimin litostratigrafik jo të veçantë, por që del nga interpretimi i operatorit, dhe nga informacioni i marrë në vënd gjatë kryerjes së provës penetrometrike. Përpunimi i të dhënave është bërë me softwarin Dynamica DPM 2.0.1 (Italy). Në këtë software për llogaritjet e parametrave të ndryshëm gjeoteknike janë përdorur korrelacionet empirike të autorëve si më poshtë:

Këndi i fërkimit prerje (°)	Mod. Edom. shkript (kg/cm ²)	Kohezioni jo drenuar (kg/cm ²)	Mod. edom. Koheziv (kg/cm ²)	Densitet elative (%)	Moduli Young kg/cm ²	Mod.dinamik ne prerje shkripta (kg/cm ²)	Mod.dinamik prerjes kohezive (kg/cm ²)	Raporti i konsolidim
Meyerhof - >5% limo	Farrent	Terzaghi & Peck	Stroud Butler 20<IP<40	Skempto 1986	Stroud	Crespellani e Vannucchi	Crespellani e Vannucchi	Ladd & Foot

Parametrat Gjeoteknik:

• Shtresa jokohezive

Dr = Dendësia relative [%]

Φ = Këndi i fërkimit të brendshëm [°]

y = Pesha e volumit [t / m³]

M = Moduli i deformimit të drenazhuar [kg / cm²]

E = Moduli i deformimit të Young [kg / cm²]

Go = Moduli i deformimit të prerjes [t / m²]

Vs = Shpejtësia e valës sizmike [m/s]

Qamm = Aftësia mbajtëse [kg / cm²]

• Shtresa kohezive

Ic = Indeksi i konsistencës

Cu = Kohezioni i padrenuar [kg / cm²]

y = Pesha e vëllimit [t / m³]

Ed = Moduli i deformimit të pakulluar [kg / cm²]

Go = Moduli i prerjes dinamike [t / m²]

Qamm = Aftësia mbajtëse [kg / cm²]

Ndpmes – Numri i goditjeve mesatare e shtresës për ulje

Detajet e Investigimit:

Janë kryer 4 prova me penetrometër dinamik në këto thellësi: **CPT 1:** 3.0 m, **CPT 2:** 3.0 m, **CPT 3:** 2,8 m, **CPT 4:** 3,5m

Ekzekutimi i provës:

Ekzekutimi i provës është kryer rregullisht, pa problem duke siguruar vertikalishtet maksimal. Gjatë nxjerrjes së astave të provës, është vërejtur material me lagështi, gjë që tregon se provat kan kalur në formacione kryesisht të dobëta dhe me lagështi.

Për llogaritjen e parametrave gjeoteknik nga kjo metodikë studimi janë përdorur korelacioni **Nspt dhe Rpd**, dhe tabelat koreluese për argjilat rërat sipas Skempton 1986.

Shtresa e parë: Dhera argjilor, shumë të shkrifëta, ngjyre kafe. Thellësia nga 0.0 m deri 0.7 m. Parametrat gjeoteknik për dhera të shkrifët (jo koherent) janë:

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Prova 4	Mesatarja
Dendësia relative Dr (%)	34.8	28.1	26.7	31.5	30.3
Këndi fërkimit të brendshëm Ø (°)	20.6	19.7	19.6	20.6	20.13
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	1.20	1.17	1.17	1.20	1.185
Moduli deformimit të drenuar M (kg/cm ²)	14.6	10.4	10	14.7	12.43
Moduli deformimit i Yungut E (kg/cm ²)	102.4	86.2	84.7	102.9	94.05
Moduli deformimit në prerje G₀ (T/ m ²)	1281	927	897	1291	806.5
Shpejtësia e valës sizmike Vs (m/sek)	107.9	105.2	106.1	114.5	108.43
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	0.5	0.3	0.33	0.5	0.41
N _{spt}	2.1	1.5	1.4	2.1	1.8
(qc/pa)/N60	4.9	4.7	4.7	4.5	4.7

Shtresa e dytë: Surëre në ngjyrë bezhë, të shkrifëta. Thellësia deri 0.7 m deri në 2 m. Parametrat gjeoteknik për dhera koherente (kohezive) janë:

	Prova 1
Indeksi konsistencës Ic	0.54
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	0.62
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	1.94
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	46.0
Moduli i prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	7910
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2.5
N _{spt}	9.2
(qc/pa)/N60	5.4

Shtresa tretë: Rëra kokërr imëta, të forta, të ngjeshura. Thellësia nga 2 m deri në 2.3 m. Parametrat gjeoteknik për dhera koherente (kohezive) janë:

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Prova 4	Mesatare
Indeksi konsistencës Ic	1.05	0.83	1.07	0.99	0.97
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	2.72	1.19	3.06	1.94	2.23
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	2.30	2.09	2.30	2.15	2.21
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	203.3	89.1	228.3	145	166.43
Moduli prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	25196	13238	27581	19355	21342.5
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	7.2	3.6	8.1	4.9	5.95
Nspt	40.7	17.8	45.7	29	33.3
(qc/pa)/N60	3.5	4	3.5	3.4	3.6

Lidhja ndërmjet vlerave të CPT dhe vetive të rrëave (sipas Curtin et. Al.2006)

	Shumë të shkrifta	Të shkrifta	Mes. të ngjeshura	Të ngjeshu ra	Shumë të ngjeshura
Vlera SPT(N goditje 0.3) ^a	< 4	4-10	10-30	30-50	> 50
CPT (qc rezistenca e konit) ^b	< 5	5-10	10-15	15-20	>20
Dendësia relative (%) ^c	< 15	15-35	35-65	65-85	85-100
Pesha vëllimore e skeletit	< 14	14-16	16-18	18-20	>20
Këndi i fërkimit (gradë)	< 30	30-32	32-35	35-38	38

Shënim a) për një ngarkesë vertikale 100kPa, b) nuk është vlera unike mund të ndryshojë nga kushtet lokale, c) depozitime të reja, rëra normalisht të konsoliduara.

Nisur nga numri i goditjeve N_{spt} (N₆₀), dhe mardhëniet me **q_c** (rezistenca e matur e konit R_{pd}) dhe **p_a** (ngarkesa vertikale 100kPa) dalim në përcaktimin e tipit të sjelljes së dherave **Ic** sipas Robertsonit 1986.

Vlera-NeSPT(TestittePenetrimitStandard)

Vlera-**N e SPT** – së derivohet duke përdorur lidhje të ndryshme midis **q_c** dhe **N60**. Këto raporte u sugjeruan nga Robertson etj. (1986) dhe tregohen në tabelën më poshtëme.

Tab.Raportet e vlerës-N e SPT – së nga Robertson etj., 1986.

Zona	TipiSjelljessë Dheut	(qc/pa)/N60
1	Kokërr imët të ndjeshëm	2
2	Material ORGANIK	1
3	Argjilë	1
4	ARGJILË pluhurore në ARGILË	1.5
5	PLUHUR argjilor në ARGJILË	2
6	PLUHUR ranor në PLUHUR argjilor	2.5
7	RËRË pluhurore në PLUHUR ranor	3
8	RËRË në RËRË pluhurore	4
9	Rërë	5
10	RËRË në RËRË zhavorrore	6
11	Kokërr imët shumë i ngurtë	1
12	RËRË në RËRË argjilore	2

Për rezultate më të mira për llogaritjen e **N60** rekomandohet përdorimi i treguesit të tipit të sjelljes së dheut, **Ic**. Marrëdhënia midis **N60** dhe **Ic** përcaktohet si:

$$\frac{qc/pa}{N60} = 8.5 (1 - Ic/4.6) \text{ (Lunne etj., 1997)}$$

Jefferies and Davies (1991), sugjerojnë se kjo metodë siguron një vlerësim më të mirë të vlerës-N të SPT-së, edhe në krahasim me vetë testin e SPT-së, për shkak të përsëritshmerisë së dobët që ka ky test.

Nisur nga formula e Robertsonit kemi nxjerrë raportin $\frac{qc/pa}{N60}$ për çdo shtresë të vendosura në tabelat e rezultateve.

Nga llogaritjet tona duke i krahasuar me përcaktimet e sjelljes së dherave sipas Robertsonit jemi në **Ic** midis 1.83 dhe 2.5 që i përket zonës SBT nr 5 /6 .

Përqindja e fraksionit të imët FC sipas kufijve të indeksit të sjelljes së dheut Ic (Robertson 1990)

Indeksi i tipit të dheut Ic	Zona SBT	Klasifikimi USCS	FC (%) Fraksioni i imët
$Ic < 1.31$	7	Rëra zhavorrore deri rëra të trasha	0
$1.31 \leq Ic < 1.59$	6	Rëra të pastra	0 - 5
$1.59 \leq Ic < 1.83$	6	Rëra me pluhur	5 - 12
$1.83 \leq Ic < 2.276$	5/6	Rëra pluhurore	12 - 35
$2.276 \leq Ic < 2.5$	5	Rëra pluhurore, Pluhurore me rëra	35 - 50
$2.5 \leq Ic < 2.68$	5/4	Pluhurore me rëra deri në rëra	50 - 65
$2.68 \leq Ic < 2.95$	4	Pluhurore argjilore deri argjila pluhurore	65 - 87.4
$2.95 \leq Ic < 3.1$	3	Argjila pluhurore	87.4 -100
$3.1 \leq Ic < 3.6$	3	Argjila	100
$Ic \geq 3.6$	2	Dhera organike, torfa	100

Nisur nga tabela e sipërme (Robertson 1990) $1.83 \leq I_c < 2.276$, kur Zona ZBT = 5/6, me përcaktimin sipas USCS “Rëra pluhurore = SM”, del që përbërja e fraksioneve është:

- Për shtresën e parë me përcaktimin sipas USCS “Rëra argjilore = SC”

$2.276 \leq I_c < 2.5$	5	Rëra pluhurore, Pluhurore me rera	35 - 50
------------------------	---	-----------------------------------	---------

Rëra argjilore ku 60% janë rëra që kalojnë nga sita Nr. 10 (2.0 mm) në sitën Nr. 40 (0.425 mm) dhe 40% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

- Për shtresën e dytë me përcaktim USCS “Rëra pluhurore = SM”

$1.83 \leq I_c < 2.276$	5/6	Rëra pluhurore	12 - 35
-------------------------	-----	----------------	---------

Rëra pluhurore ku 85% janë rëra që kalojnë nga sita Nr.10 (2.0 mm) në sitën Nr.40 (0.425 mm) dhe 15% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

- Për shtresën e tretë me përcaktim USCS “Rëra pluhurore = SM”

$1.83 \leq I_c < 2.276$	5/6	Rëra pluhurore	12 - 35
-------------------------	-----	----------------	---------

Rëra pluhurore ku 80% janë rëra që kalojnë nga sita Nr. 10 (2.0 mm) në sitën Nr. 40 (0.425 mm) dhe 20% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

TABLE 6.9 Klasifikimi i dherave sipas AASHTO

Ndarja	Grupi	AASHTO simboli	Emertimi	Analiza sites % e kalimit	Limiti i Atteberg
Material granular (35% ose me pak kalon ne siten Nr.200)	Grupi A-1	A-1-a	Fragmente shkambi ose zhavorri	% e kalimit: No. 10 $\leq$ 50% No. 40 $\leq$ 30% No. 200 $\leq$ 15%	PI $\leq$ 6
		A-1-b	Perzierja zhavorri rere	No. 40 $\leq$ 50% No. 200 $\leq$ 25%	PI $\leq$ 6
	Grupi A-3	A-3	Rera te imta joplastike	No. 40 $>$ 50% No. 200 $\leq$ 10%	PI = 0 joplastik
	Grupi A-2	A-2-4	Rere dhe zhavorri lymor	% e kalimit sita Nr.200 $\leq$ 35%	LL $\leq$ 40 PI $\leq$ 10
		A-2-5	Rere dhe zhavorri lymor	% e kalimit sita Nr.200 $\leq$ 35%	LL $>$ 40 PI $\leq$ 10
		A-2-6	Rere dhe zhavorri argjilor	% e kalimit sita Nr.200 $\leq$ 35%	LL $\leq$ 40 PI $>$ 10
		A-2-7	Rere dhe zhavorri argjilor	% e kalimit sita Nr.200 $\leq$ 35%	LL $>$ 40 PI $>$ 10
Material lymor-argjilor (Me shume se 35% kalon ne siten Nr.200)	Grupi A-4	A-4	Dhera lymore	% e kalimit sita Nr.200 $>$ 35%	LL $\leq$ 40 PI $\leq$ 10
	Grupi A-5	A-5	Dhera lymore	% e kalimit sita Nr.200 $>$ 35%	LL $>$ 40 PI $\leq$ 10
	Grupi A-6	A-6	Dhera argjilore	% e kalimit sita Nr.200 $>$ 35%	LL $\leq$ 40 PI $>$ 10
	Grupi A-7	A-7-5	Dhera argjilore	% e kalimit sita Nr.200 $>$ 35%	LL $>$ 40 PI $\leq$ LL - 30 PI $>$ 10
		A-7-6	Dhera argjilore	% e kalimit sita Nr.200 $>$ 35%	LL $>$ 40 PI $>$ LL - 30 PI $>$ 10
Shume organike	Grupi A-8	A-8	Torfe ose dhera shume organike	Primarily organic matter, dark in color, and organic odor	

Bazuar ne ndarjet granulometrike të shtresave (fraksioni i imët FC sipas kufijve të indeksit të sjelljes së dheut I_c (Robertson 1990), kryejmë klasifikimin e dherave të trasesë sipas AASHTO. Në këto kushte vlerësojmë se :

- 1- Për shtresën e parë klasifikimi sipas AASHTO është Grupi A-7 me simbol AASHTO A- 7 – 5.
- 2 - Për shtresën e dytë klasifikimi sipas AASHTO është Grupi A-2 me simbol AASHTO A- 2 – 6.
- 3- Për shtresën e tretë klasifikimi sipas AASHTO është Grupi A-2 me simbol AASHTO A- 2 – 5.

9.1- Kushtet gjeologjike të trasesë së rrugës në gërmime

Në segmentin që do të ketë gërmime, bazuar në të dhënat gjeologjike të marra në terren dhe analizat fiziko - mekanike, ne rekomandojmë të merren masat e mëposhtme:

1. Skarpatat e gërmimeve me kënd për depozitimet gëlqerore të jenë në raportet 3V dhe 1H (kënd skarpate 76^0), me lartësi shkalle 5m e gjerësi berme 3,5 m, me kanal në bermë, kur thellësia e kanalit të jetë deri 1,5m.
2. Skarpatat e gërmimit për depozitimet terigjene të jenë në raportet 3V dhe 2H, (kënd skarpate 53^0), me lartësi shkalle 5m e gjerësi berme 3,5m, me kanal në bermë, kur thellësia e kanalit të jetë deri 1,5m.
3. Bazuar në parametrat e plasticitetit, gjatë gërmimeve paketat argjilore të mos lihen të ekspozuara për një kohë të gjatë, pasi ato janë me plasticitet të lartë e të predispozura për të krijuar rrëshqitje. Ndaj të hapen kanale drenimi të ujrave në kurorë të skarpatave dhe nëpër berma.

9.2 - Kushtet gjeologjike të zonave ku traseja e rrugës është në mbushje

Në segmentet ku do të ketë mbushje të mëdha rekomandohet:

1. Të pastrohet toka vegjetale dhe mbi atë të ndërtohet mbushja e rrugës. Në dy anët e rrugës të ndërtohen kanalet anësore të cilat do të sigurojnë një trup rruge të drenazhuar.
2. Në rastet kur relievi ku kalon traseja është me pjerrësi më shumë se 15^0 rekomandohet:
 - a) Që të krijohet një shkallëzim nën trupin e mbushjes.
 - b) Të bëhet drenazhimi i shpatit për të siguruar një stabilitet të përgjithshëm të shpatit dhe pastaj të bëhet ndërtimi i trupit të rrugës.
3. Në ato raste kur lartësia e trupit të rrugës është mbi 10 m rekomandohet të përdoren mbushje të përforcuara (Teramesh).
4. Në rastet kur trupi i rrugës krijon kushte për grumbullim të ujrave në anët e rrjedhjeve ujore, të krijohen mundësi për drenimin e ujrave nëpërmjet materialit të trashë të mbushjes ose me kanale drenimi nën trupin e rrugës.

9.3 - Gërmimet e Skarpatave dhe masat Inxhinerike për stabilizimin e tyre

Vlerësimet për gërmimet e reja të rrugës janë bazuar në rezultatet e gjithë punimeve fushore në terren, provave “in-situ”, testimeve gjeologjike dhe gjeoteknike në përgjithësi. Për ndërtimin e rrugës, do të kryen gërmime për zgjerimin e trasesë së rrugës.

